REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ZYRA SHQYRTUESE I PROKURIMIT - TELOJA KADRIA NE EMER TE KOMISIONIT

Nr/Br. 182/17
Data/Datum 14.06.2017

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **205-17-386-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ri asfaltimi i rrugës Rajonale R220, segmenti Bukosh - Prilluzhë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Konzorciumi "ILEAA-GR" sh.p.k. dhe "GRANITI COM" sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Agim Ramadani A2/84, Prishtine, & Rruga Ilaz Kodra,Nr.315,Skenderaj
(Adresa)

Prishtine dhe Skenderaj — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+[redacted] — /
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Enis Veliqi dhe Fidaim Imeri
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[redacted] *dhe* [redacted]
(Adresa elektronike)

14.06.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Po [X] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne kemi bere kerkes per rishqyrtim me date 29.05.2017 pran autoritetit kontraktues – Ministris se Infrastruktures, mirpo fatkeqsisht me daten 12.06.2017 permes e-mailit njoftohemi ana e AK se kerkesa jone eshte refuzuar si e pa bazuar duke mos dhane asnje pergjigje me shkrim per pretendimet tona ankimore.
AK per habi deklaron se mangesit e ofertes se rekomandura per kontrat jane devijime te vogla pa dhene elaborim faktik dhe ligjor lidhiur me pretendimet tona ankimore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e perzgjedhjes se ofertes te rekomanuar per shperblim me kontrat – AK ka rekomanduar konzorciumin " 2A Group – 2T – ALKOIMPEX" nga Prishtina me qmim prej 1,477,711.09 euro. AK me rastin e rekomandimit per shperblim me kontrat ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së, sepse konzorciumi rekomanduar per shperblim me kontrat eshte i papergjegjeshem, ngase ne gjate qasjes ne dokumentacionin tenderik kemi vrejtur se te njejti konzorcium ka nderhyrje ne Paramasen e Projektit ne piken 1.3 Punet Toksore, posicioni 1.3.1 Sasia e Paramases është 72,075.00 m3 ndersa ne Paramasen e Ofertuar nga OE kemi Sasine prej 75,072.00 m3 me një ndryshim nga ajo qe është ne FDT, Leter Perkrahja nga banka është kerkuar me vlere të caktuar monetare prej 300,000.00 €, ndersa letere e ofruar nga OE nuk permban vleren e kerkuar, Marrveshja per Krijimin e Grupit të OE nuk është e vulosur dhe e nenshkruar nga të tre OE e involvuar ne ketë projekt, Udhëheqesit të punishtes i mungon licenca nga ministria e arsimit qe i ploteson kriteret për posicionin e kerkuar ne FDT, ku i mungojne Referencat dhe Kontrata e Noteruar gjithnjë sipas FDT, Inxhinierit të Hidroteknikes – z. Erjan Cela i mungon Kontrata dhe Referencat e kërkuara sipas FDT, Inxhinierit të komunikacionit z.Artan Saka i mungojne Referencat për projekte të natyres se ngjajshme. Nga te cekurat e me siperme rezulton se AK ne rastin konkret ka bere edhe shkelje te nenit 69 te LPP-së si dhe shkelje te nenit 39.8 te UOPP-së. Si dhe shkelje te nenit 59 paragrafit 2 te LPP-së, sepse ndryshimi i paramases perben edhe ndryshim material te dosjes se tenderit.Gjithashtu AK ne rastin konkret ka bere edhe shkelje te nenit 60 par.1 pika 1.1 sepse AK ne rastin konkret nuk e ka shperblyer operatorin

ekonomik dhe te pergjegjeshem.Po ashtu AK me rastin e marrjes se vendim per rekomandim per shperblim konzorciumin " 2A Group – 2T – ALKOIMPEX" ka bere shkelje te nenit 61 te LPP-së si dhe nenin 3.1 te rregullave për tenderët Jo-Normalisht të Ulët (te aprovuar nga ana e krpp-së) sepse nese mirren parasysh ofertat e operatorve te pergjegjeshem per kete aktivitet te prokurimit dhe nese krahasohen me oferten e konzorciumit te rekomanduar per shperblim me kontrat – perfundimi sjell vetem nje rezultat se oferta e konzorciumit te rekomanduar per shperblim me kontrat eshte jo normalish e ulet dhe se kjo ofert do te duhej te shpallej e pa pergjegjshme. Mbetemi me shprese se kete pretendim do ta mbeshtes dhe do ta shtjelloj me gjersisht eksperti i OSHP-së kur te bene krahasimin e ofertave per kete aktivitet te prokurimit.
Po ashtu ne e kontestojm ne tersi edhe oferten e operatorit ekonomik " FAMIS CO " si ofert e dy e pergjegjeshme per kete aktivitet te prokurimit sepse gjate qasjen ne dokumentacion tenderik te ketij ofertusi kemi vrejtur se i njejti eshte i papergjegjeshem dhe si i mungojn keto doumente si ne vijim: Raporti të Auditimit i mungon Licenca e Auditorit e Noteruar, e cila është e kërkuar me FDT, Menaxherit të projektit i mungon Kontrata e Noteruar, e cila është e kërkuar me FDT, Gjeodeti i kerkuar i mungon Kontrata e Noteruar, e cila është e kërkuar me FDT, Inxhinieri i Komunikacionit i kërkuar është për Rikonstruim ose Ndërtim të rrugëve, si kriter i kërkuar me FDT, ndersa OE ne fjale e ka ofruar Inxhinier të Komunikacionit për transport, të cilit poashtu i mungon Kontrata e Noteruar.
Pra ky operator ekonomik eshte i pa pergjegjeshem nese i referohemi dispozitave te LPP-së dhe atë nenit 7, 59, 60, 69, 52, 51, 40, 41.
Nese referohemi fakteve dhe provave te siper theksuara rezulton se operatori ekonomik i rekomanduar konzorciumin " 2A Group – 2T – ALKOIMPEX" si dhe OE " FAMIS CO " jane operator te papergjegjshem dhe se te njejtit nuk kane asnje interes juridiko material konforn nenit 111 te LPP-së lidhur me neni 4.1.26 te LPP-së i propozoj panelit shqyrtues qe ankesen tone ta aprovoj si te bazuar- me qense jemi pale qe ka interes juridiko material sipas neni 111 te LPP-së dhe lenden per kete aktivitet te prokurimit ta kthen ne rivlersim.
Mbes me shpres qe ankesa jone dhe pretendimet tona ankimore te studiohen dhe te sqarohen – dhe ne fund te faktohen nga ana e ekspertit shqyrtues dhe paneli shqyrtues dhe ne fund te mirret vendim meritor nga ana e panelit shqyrtues konform dispozitave te LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK me rastin e perzgjedhjes se ofertes te rekomanuar per shperblim me kontrat – AK ka rekomanduar konzorciumin " 2A Group – 2T – ALKOIMPEX" nga Prishtina me qmim prej 1,477,711.09 euro. AK me rastin e rekomandimit per shperblim me kontrat ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së, sepse konzorciumi rekomanduar per shperblim me kontrat eshte i papergjegjeshem, ngase ne gjate qasjes ne dokumentacionin tenderik